



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1388/1 Prot.

Tiranë, më 14 / 10 / 2020

V E N D I M

Nr. 136, Datë 14 / 10 / 2020

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 102, datë 24.09.2020, të paraqitur nga B.M kundër G.J.F, Specialist në Drejtorinë e Standarteve Profesionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, N.N, Drejtor i Drejtorisë së Standarteve Profesionale, E.M, Drejtor i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, A.V, N.R, A.D, SH.S, G.N, anëtarë të Komisionit Qendror të Apelit dhe A.V, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike” dhe “çdo shkak tjetër¹”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga B.M, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Me Urdhërin Nr. 665/1 datë 11.08.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm është përjashtuar nga Policia e Shtetit. Prej 11 vitesh ka qenë pjesë e Policisë së Shtetit, ku së fundmi ka mbajtur gradën policore “Nënkomisar” dhe ishte punonjës në Komisariatin e Policisë Kufitare, Aeroporti Rinas, komisariat ky në varësi të Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit, Tiranë. Me datë 16.05.2020, duke qenë në detyrën e Specialistit të Zbatimit të Masave Plotësuese (Specialist Hetimi) dhe kolegu i tij me detyrën e Ndihmës Specialistit për Zbatimin e Masave Plotësuese, janë arrestuar me vendim të Gjykatës Speciale Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit,

¹ Pa përcaktuar një cilësi apo shkak.

ku ndaj tij dhe kolegut të tij është caktuar masa e sigurisë “Arrest në shtëpi”, si person i dyshuar për veprën penale të parashikuar nga Neni 248-25 i Kodit Penal. Brenda 48 orëve kanë dalë përpara gjykatës, në seancën e verifikimit të kushteve të masës së sigurisë, dhe i njëjti gjyqtar që kishte caktuar masën e sigurisë, pasi dëgjoi pretendimet dhe argumentet e tij, e zëvendësoi masën, në “Detyrim për tu paraqitur në Policinë Gjyqësore”. Ankuesi sqaron se ndaj tij nuk është kryer asnjë hetim disiplinor nga hetuesi disiplinor i Drejtorisë së Standardeve në D.P.P.SH, G.J.F por në Raportin Përfundimtar Nr. 666/7, datë 05.06.2020, në pjesën konkluzion, shkruhet se: “Është nën hetim nga SPAK, për veprën penale “Shpërdorim i detyrës”, ka kryer veprime në shkelje të atribueteve të punonjësit të Policisë së Shtetit dhe në shpërdorim të detyrës, pra duke kryer shkelje të rëndë”, parashikuar nga Neni 209 i Rregullores së Policisë së Shtetit, pa treguar llojin e shkeljes konkrete, faktet dhe provat që ka mbledhur, që ka arritur në atë konkluzion. Raporti përfundimtar është miratuar dhe firmosur nga Drejtori i Drejtorisë së Standardeve Profesionale, Drejtues i Parë, N.N. Bazuar në këtë raport të Drejtorisë së Standardeve Profesionale, me Vendim nr. 208, datë 05.06.2020, është vendosur dhënia e masës disiplinore, “Përfjashtim nga Policia”, nga Drejtori i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, Drejtues i Lartë, E.M. Vendimi është apeluar në Komisionin Qendror të Apelit, në DPPSH. Komisioni me Vendimin nr. 95, datë 30.07.2020 “Për shqyrtimin e ankesës për masë disiplinore”, vendosi të konsiderojë të motivuar masën “Përfjashtim nga Policia” të dhënë ndaj tij. Komisioni i Apelit përbëhej nga 5 anëtarë; Kryetar, Drejtues i Lartë, A.V, anëtarë, Drejtues të Parë: G.N, SH.S, N.R dhe Drejtues, A.D. Edhe Komisioni i Apelit ka pasur detyrimin të hetojë për të vërtetuar fajësinë ose jo, nëse qëndronin pretendimet e ankuesit apo jo, dhe kanë pasur edhe kohën e nevojshme në dispozicion, rreth 40 ditë pune, pasi në Rregulloren e Policisë së Shtetit, Neni 247 “Procedura e shqyrtimit të ankimit”, pika 8, shkruhet: “Vendimi i Komisionit të Apelit duhet të jetë i arsyetuar dhe i bazuar në prova, fakte shkresore, si dhe në aktet normative në fuqi”. Në vendimin e komisionit nuk ka asnjë provë të vetme apo fakte shkresore. Pra, edhe prej 5 anëtarëve të Komisionit të Apelit ndjehet i diskriminuar, krahasuar me raste të ngjashme, duke i sjellë pasoja të rënda profesionale, psikologjike dhe ekonomike. Ankuesi informon se kolegu i tij B.I, me të cilin është në hetim nga prokuroria, si të dyshuar për shpërdorim detyre në bashkëpunim, nuk është liruar nga detyra siç është vepruar me të. Ankuesi informon se në një rast të ngjashëm, Policia e Shtetit nuk ka vepruar si në rastin e ankuesit duke e liruar nga detyra. Ankuesi i referohet praktikës së ndjekur për rastin e punonjësve që janë nën hetim: E.T, me detyrë Drejtore e Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit, Tiranë, B.Z, me detyrë, Shefi i Sektorit në DRKM, Tiranë, A.H, me detyrën e Shefit të Seksionit në DRKM, Tiranë, A.M, me detyrë specialiste në DRKM, Tiranë. Rasti i këtyre punonjësve është trajtuar si skandal mediatik trafikimi dhe korrupsioni në emisionin, Top Story në Top Channel. Këto punonjës policie janë ndaluar nga SHÇBA, rreth 10 ditë pas arrestimit të tij dhe dyshohen për disa vepra penale të kryera në bashkëpunim, aktualisht janë në të njëjtin status penal me ankuesin, si persona nën hetim, hetohen nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjithashtu, mund të krahasohet dhe praktika e ndjekur për përfjashtimin nga policia e ish-punonjësve të Policisë së Shtetit, E.LL dhe A.D, ish-punonjës të Komisarariatit të Policisë Kufitare Aeroporti Rinas. Këto punonjës policie, edhe pse kanë qenë nën masën e sigurisë

“Arrest me burg” dhe të hetuar nga SPAK, për vepër penale, në kuadrin e grupit të strukturuar kriminal, në dijeninë e tij janë përjashtuar nga Policia e Shtetit, pas një periudhe kohore sa pesë fishi i kohës që ju nevojiti për përjashtimin e tij. Nëse ankuesi do lihej i pezulluar nga detyra për aq kohë sa i lanë dy punonjësit e sipërcituar, shumë shpejt do kishte në dorë pushimin e çështjes ose pafajësinë nga gjykata, dhe do kishte hapësirën ligjore të rifillonte punë dhe jo të qëndronte pa punë dhe pa të ardhura monetare. Ankuesi shprehet se këto veprime janë bërë për shkak të bindjes të tij politike që është në kundërshtim me partinë që qeveris vendin, kjo së paku që prej zgjedhjeve të fundit parlamentare dhe lokale. Ankuesi shprehet se, jemi një vend i vogël dhe bindjet politike nga punëdhënësi merren vesh, pasi mund të jetë shprehur që nuk ka votuar Kryetarin e Bashkisë në Tiranë. Në respekt të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, ankuesi shprehet se nuk ka marrë pjesë si anëtar në asnjë subjekt politik. Ankuesi informon se një arsye tjetër për të cilin është liruar nga detyra, është dhe fakti për të favorizuar një person tjetër me përkrahje shoqërore dhe lidhje miqësore më të forta se ai”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin në Policinë e Shtetit.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një

karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi, bindja politike dhe çdo shkak tjetër.

Lidhur me identifikimin e “bindjeve politike” nga ankuesi, si shkak i mundshëm diskriminimi, me argumentimin se ai nuk ka qenë i anëtarësuar në asnjë parti politike për shkak të profesionit, por nuk ka votuar partinë në pushtet dhe për këtë fakt ai po diskriminohet, Komisioneri vlerëson se është i pabazuar, pasi ankuesi pranon se, *“Pas përjashtimit nga Policia e Shtetit, është anëtarësuar në subjektin politik PD”*. “Bindjet politike” që të shërbejnë si shkak për trajtimin e padrejtë apo të pabarabartë të ankuesit, duhet të jenë një cilësi e vetë personit, pasi pikërisht bazuar në këtë karakteristikë që ai posedon mund të pretendohet se ai është diskriminuar. Ankuesi në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument, indicie apo provë, për të vërtetuar bindjen e tij politike.

Gjithashtu, ankuesi në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument, indicie apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë shkakut specifik, duke mos arritur të identifikojë se cili është ky shkak, pasi *“favorizimi i një personi tjetër me përkrahje shoqërore dhe lidhje miqësore më të forta se ai”* nuk është shkak në vetvete dhe karakteristikë personale e ankuesit.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, shpjegimet e ankuesit për identifikimin e “bindjes politike” apo “çdo shkak tjetër” si shkaqe për trajtimin e tij të pabarabartë nga ana e nëntë punonjësve dhe drejtuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit nuk qëndrojnë dhe nuk janë të mbështetura në argumente logjike dhe prova.

Referuar përmbajtjes së nenit 1 të Ligjit 10221/2010, rezulton tepër e qartë dhe evidente, që të gjitha shkaqet e përmendura, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me cilësi, apo karakteristika individuale të personave që pretendojnë për diskriminim. Situata diskriminuese në vetvete është gjithmonë e lidhur me një veçori individuale të viktimës dhe në rastin konkret, ankuesi ka indentifikuar por nuk ka provuar një shkak të vlefshëm diskriminimi, që të ketë lidhje me një nga karakteristikat personale të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkaqeve të pretenduara nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Komisioneri vlerëson se, B.M mund të jetë vënë përpara veprimeve ose mosveprimeve të padrejta të punonjësve dhe drejtuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, por në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga ankuesi, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së shtetasit B.M, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONER

Robert GAJDA